



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:085662
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05639355

CPP.nr.27/2024

Gjykata Themleore në Mitrovicë-Dega në Vushtri - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Leotrim Gashi, në çështjen juridike përmbarrimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësit (KRU) “Mitrovica”, SH.A, me adresë Rr. “Bislim Bajgora”, pa nr, kundër debitorit F.S, me vendbanim në V, Rr. “M.S”, me bazë juridike pagesa e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme të ushtruar nga A.S (i biri i debitorit F.S) për dorëzimin personalisht të Urdhrit të Përmbarruesit Privat Atip Mustafa, P.nr.1750/19, i datës 31.10.2019 sipas detyrës zyrtare, jashtë seancës, me datë 30.04.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I.** SHFUQIZOHET Urdhri përmbarrimor i Përmbarruesit Privat Atip Mustafa P.nr.1750/19 i datës 31.10.2019, ashtu që HUDHET SI I PALEJUAR propozimi për përmbarrim kreditorit KRU “Mitrovica”, SH.A, i datës 31.10.2019, kundër debitorit F.S.
- II.** HUDHET SI I PALEJUAR propozimi për kthimin në gjendjen e mëparshme i datës 29.02.2024, i paraqitur nga A.S.

A r s y e t i m

Kreditori KRU “Mitrovica”, SH.A nga Mitrovica, me datë 31.10.2019 ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarrimit ndaj debitorit F.S, në bazë të dokumentit të besueshëm- faturës V3416, për shpenzimet e ujit dhe të kanalizimit, në shumën prej 2,451.89 euro.

Përmbarruesi Privat Atip Mustafa, duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit, ka nxjerrë Urdhrin P.nr.1750/19, i datës 31.10.2019, duke lejuar përmbarrimin e propozuar.

Në zyrën e Përmbarruesit Privat, me datë 29.02.2024, ka paraqitur propozim për kthimin në gjendjen e mëparshme A.S (i biri i debitorit F.S), me arsyetimin se urdhri përmbarrimor nuk i

është dorëzuar asnjëherë personalisht debitorit dhe se ai nuk ka njohuri se kush e ka pranuar atë urdhër përmbarimor, çka ka ndikuar që të humbet afati për kundërshtimin e Urdhrit.

Gjykata fillimisht vlen të thekson se propozimin për kthimin në gjendje të mëparshme lidhur me këtë Urdhër përmbarimor, e ka nënshkruar Ahmet Sekaci, i cili nuk është palë debitore e kësaj çështje përmbarimore i as përfaqësues i debitorit.

Gjykata me datë 28.03.2024, ka marrë aktvendimin CPP.nr.27/2024, me të cilin e ka obliguar paraqitësin e propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme A.S, që gjykatës t'ia dorëzoj autorizimin për përfaqësimin e debitorit F.S në këtë çështje.

A.S, me datë 24.04.2024, në gjykatë e ka dorëzuar certifikatën e vdekjes nr. V10677408, të datës 24.04.2024,të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, me të cilën konstatohet se debitori F.S, ka vdekur me datë 22.03.2003.

Gjykata në procedurën përmbarimore pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar shkresat e tjera të lëndës ka gjetur se propozimi për kthim në gjendjen e mëparshme i paraqitur i biri i debitorit, duhet hedhur si i palejuar si dhe urdhri përmbarimor të shfuqizohet në tërësi, për arsye si në vijim:

Shqyrtimi i prezumimeve procedurale për fillimin e procedurës përmbarimore

Gjykata konstaton se kreditori KRU “Mitrovica”, SH.A, me datë 31.10.2019, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit kundër debitorit F.S, në bazë të dokumentit të faturës V3416, për shpenzimet e ujit dhe të kanalizimit, në shumën prej 2,451.89 euro.

Prezumimi procedural për të qenë palë në procedurën përmbarimore është parim qendror, nga e cila varet lejueshmëria e procedurës përmbarimore, të cilin gjykata e vlerëson sipas detyrës zyrtare. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se kreditori ka paraqitur propozimin për përmbarim ndaj debitorit F.S, edhe pse i njëjti kishte vdekur më datë 22.03.2003, pra para me shumë se 16 vite para se kreditori të paraqiste propozimin për përmbarim me datë 31.10.2019 .

Gjykata pas shqyrtimit të aftësisë procedurale të palës debitore, rezulton se debitori F.S, kishte qenë konsumtor i kreditorit bazuar në faturës V3416 dhe i njëjti kishte vdekur me 22.03.2003. Kjo rrethanë është vërtetuar përmes Certifikates së Vdekjes me V10677408, të datës 24.04.2024,të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, në emër të F.S, me adresë, Rr “M S” në V.

Sipas nenit 76 par.1 të LPK-së përcaktohet “*Gjatë tërë procedurës gjykata duhet të kujdeset, sipas detyrës zyrtare nëse personi që paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë dhe nëse është me zotësi procedural, nëse palën me pazotësi procedural e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor, dhe nëse përfaqësuesi ligjor ka autorizimin e veçantë, kur ai është i nevojshëm*”.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se një propozim i tillë për përmbarim është i palejueshëm në aspektin procedural, për faktin se me vdekjen e debitorit shuhet edhe aftësia juridike e palës dhe rrjedhimisht, i njëjti nuk mund të cilësohet palë në këtë procedurë përmbarimore. Duke qenë se propozimi i tillë që në fillim ka qenë i palejuar, gjykata sipas detyrës zyrtare shfuqizoi edhe

urdhrin për përmbarrim të përmbarruesit privat, sepse ishte lëshuar nga një propozim i parregullt juridikisht, sepse procedura përmbarrimore është filluar nga përmbarruesi privat ndaj debitorit i cili kishte vdekur para më shumë se 16 viteve para se të paraqitej propozimi për përmbarrim.

Me nenin 18 të LPP-së, përcaktohet se “*Dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, të parapara për dërgimin e shkresave, vlejné edhe për aktvendimin për përmbarrimin, urdhrin për përmbarrim, aktvendimin lidhur me prapësimin kundër aktvendimit për përmbarrim dhe aktvendimit për gjobën me të holla*”, ashtu që me nenin 110.1 të LPK-së thuhet se “*Padia, përgjigjja në padi, letërthirja për në seancë, urdhërpagesa, aktgjykimi dhe aktvendimi, kundër të cilit lejohet ankimi i veçantë, mjeti i goditjes së vendimit, i dorëzohet personalisht palës gjegjësisht përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit me prokurë të saj...*”, ndërsa me nenin 47.4 të LPP-së është paraparë që “*Aktvendimi për përmbarrimin apo urdhri për përmbarrim i dërgohet kreditorit dhe debitorit apo përfaqësuesve të tyre. Aktvendimi me të cilin hedhet poshtë apo refuzohet propozimi për përmbarrim i dërgohet vetëm kreditorit*”, prandaj duke marrë parasysh se urdhri për përmbarrim duhet t’i dërgohet personalisht palës, në këtë rast debitorit, gjykata e ka të paqartë se si në flet kthesën për dërgimin e urdhrin P.nr.1750/19, te vendi për nënshkrimin e marrësis, ekziston një nënshkrim për pranimin e tij nga marrësi me datë 01.11.2019, ndërsa në anën tjetër debitori sipas certifikatës së vdekjes, ka vdekur me datë 22.03.2003 dhe në këtë mënyrë nuk identifikohet se nga kush është pranuar ky urdhër, i cili dorëzim është konsideruar si formë e rregullt e dorëzimit.

Gjykata vlen të thekson po ashtu se është i rëndësishëm momenti i vdekjes së debitorit në raport me paraqitjen e propozimit nga ana e kreditorit, sepse ky moment determinon zbatueshmërinë e nenit 35 par.4 të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore, që përcakton se “*Në rast të vdekjes së debitorit që nuk ka përfaqësues ligjor apo me prokurë, Gjykata, brenda afatit prej pesëmbdhjetë (15) ditësh nga dita në të cilën është njoftuar për vdekjen e debitorit, emëron përfaqësuesin e përkohshëm në emër të trashëguesve të debitorit në ngarkim të shpenzimeve të kreditorit, si rregull nga radha e personave që e kanë në posedim pasurinë që është objekt përmbarrimi, dhe vazhdon procedurën. Gjykata e emëron përfaqësuesin e përkohshëm brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, nga dita e parashtrimit të kërkesës. Po qe se personat e autorizuar nuk e propozojnë vazhdimin e procedurës brenda afatit që u është caktuar, Gjykata e pezullon procedurën përmbarrimore. Gjykata mund të emërojë vetëm një person që nuk ka interes personal në konflikt me interesat e debitorit, dhe përfaqësuesi i përkohshëm ka për detyrë që të veprojë në interes të debitorit. Personi i emëruar ka të drejtën që të refuzojë emërimin, dhe Gjykata në atë rast ka të drejtën që të emërojë një zëvendësues*”. Prandaj, në këtë rast, gjykata nuk ka pasur mundësi të veprojë sipas nenit 35 par.4, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm ndaj debitorit, sepse kjo dispozitë ligjore rregullon situatën juridike vetëm nëse vdes debitori gjatë zhvillimit të procedurës përmbarrimore, ku në këtë rast duhet të merren veprimet procedurale nga kreditori, që të propozoj caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, kurse në rastin konkret, debitori kishte vdekur shumë vite para se paraqitej propozimi për përmbarrim nga ana e kreditorit.

Duke qenë se propozimi për përmbarrim ka qenë i palejuar juridikisht dhe pasi gjykata ka shfuqizuar në tërësi Urdhrin për përmbarrim, atëherë gjykata vendosi që edhe propozimin për kthim në gjendje të mëparshme të paraqitur nga i biri i debitorit ta hedhë poshtë si të palejuar,

sepse në këtë fazë të procedurës i njëjti nuk e ka cilësinë e debitorit e as nuk është i përfaqësues i tij.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 17 të LPP-së dhe nenit 76 par.1 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2024:085662, CPP.nr.27/2024, me datë, 30.04.2024**

Gj y q t a r i

Leotrim Gashi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afatin prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.